

OPERATORI I SISTEMI TË SHPËRNDARJES

**“Spostimi i linjave TM/TU që ndodhen në aksin e ri rrugor
Thumanë- Kashar loti II.”
RELACIONI TEKNIK**

PËRMBLEDHËSE

| | | |
|-----|--|---|
| 1. | Hyrje..... | 4 |
| 1.1 | Pozicioni gjeografik | 5 |
| 1.2 | Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të rrjetit..... | 6 |
| 2. | Treguesit e vlerësimit të performancës..... | 6 |
| 2.1 | Domosdoshmëria..... | 6 |
| 2.2 | Demontimet | 6 |
| 3. | Objektivat dhe qëllimet e projektit..... | 7 |
| 4. | Projekti i spostimit te linjave 0.4 , 6 dhe 20 kV..... | 7 |
| 4.1 | Fazat e projektit të zbatimit..... | 7 |
| 4.2 | Kriteret e projektimit | 8 |
| 5. | Dokumentacioni..... | 8 |

1. Hyrje

Rajoni i Durrësit është ndër rajonet më të mëdha të Shqipërisë. Zona e segmentit rrugor Thumanë-Tapizë do të ndërtohet i ri me standart rruge autostrade. Ky faktor i ndërtimit te aksit të ri rrugor Thumanë-Tapizë bën që të lindë nevoja e sistemimit te linjave TU/TM të cilat intersekojnë këtë rrugë.

Projekti përmban spostimin e linjave të tensionit të ulët dhe të mesëm, 6 dhe 20 kV dhe zëvendësimin e nje kabine shtyllore 6kV. Ky projekt është i nevojshëm pasi në këtë zonë do të shtrihet aksi i ri rrugor Thumanë-Tapizë.

Projekti përfshin një zonë gjeografike prej 12.5 km trase rruge.

Më poshtë është përshkrimi për gjendjen ekzistuese të rrjetit TU/TM për zonën që do të kryhet investimi, projekti i ri dhe materialet që do të përdoren për zbatimin e projektit dhe llogaritjet teknike.

1.1 Pozicioni gjeografik

Projekti i përgjithshëm shtrihet nga km 0 (Thumanë) deri në km 12.5 (Ura e Gjolës).




Figura 1.1. Pozicioni gjeografik i zonës.

1.2 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese të rrjetit.

Aktualisht kjo zonë furnizohet nga fiderat 20 kV dhe 6 kV të Nënstacionit 110/20/6 kV Fushë- Krujë.

Do të bëhen 12 intersektime nga ku janë 9 linja tensioni të ulet me kabull ABC , 6 intersektime linjash ajrore të tensionit të mesem 6 kV dhe 2 linja kablllore 20 kV .

Gjatësia e intersektimeve varion nga 80-90m sipas gjerësisë së rrugës.

2. Treguesit e vlerësimit të performancës

2.1 Domosdoshmëria

Për arsyet e ruajtjes së distancave,eliminimin e rrezikshmërisë lind nevoja që këto intersektime të bëhen nëntokesore sic jane parashikuar në projekt.

2.2 Demontimet

Përpara fillimit të punimeve të zbatimit të këtij projekti, Drejtoria Rajonale Durrës të organizojë punën për inventarizimin e aseteve të kompanisë që ndodhen në zonën e prekur nga projekti. Gjatë zbatimit të projektit dhe në përfundim të tij kjo drejtori të marrë masa për ruajtjen, demontimin dhe magazinimin e aseteve të OSSH.sh.a. Në bazë të inventarit bëhet demontimi nga "DRD" në zbatim të rregullores së sigurimit teknik, duke mbajtur proces – verbalet përkatës. Në rast se është e nevojshme për këtë njoftohen Mbikëqyrësi dhe drejtuesi i Punimeve. Materialet e demontuara bëhen hyrje në magazinën e "OSSH. sh.a." Për të gjitha materialet e demontuara dhe magazinuar pasi mbahen dokumentet përkatës në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të bëhet pasqyrimi në dokumentet teknike dhe ekonomike të kompanisë.

3. Objektivat dhe qëllimet e projektit

Në bazë të rregullores së sigurimit teknik për të sistemuar linjat TM dhe TU të cilat intersektohen përgjate trasesë 12.5 km te rruges Thumanë-Tapizë lind nevoja e spostimit të tyre. Për të ruajtur distancat dhe zbatuar rregulloren e sigurimit këto intersektime do të bëhen nëntokesore. Kabulli TM do të zbresi dhe do të ngjitet në shtyllat perkatëse sipas projektit, do të futet në tub celiku Ø219 brënda të cilit do të futet tub PVC Ø160mm². Përgjate kalimit të rrugës në skajet e kabullit do të vendosen koka kabulli TM dhe shkarkus TM në të dy krahët e linjes.

Në linjat TU zbritja dhe kalimi në toke do të realizohet me kabull Al4x95mm², tip XLPE dhe në të dy skajet do të vendosen terminale bashkuese për kabullin ABC me PVC. Gjate kalimit të autostrates kabulli do të futet në tub celiku Ø219 brënda të cilit do të futet tub PVC Ø160mm².

Ndërsa në rastet ku kemi linje 20kV kabllore në të dyja skajet e intersektimit do të vendosen puseta dhe kalimi do të bëhet me tub celiku Ø219 brënda të cilit do të futet tub PVC Ø160mm² për secilen linje.

Nga km 0 deri në km 8 do të vendosen 6x2 tuba rezerve për prespektivën e rrjetit të ri 20kV në mënyrë që mos të ketë më ndërhyrje në aksin e ri të autostradës.

4. Projekti i spostimit të linjave 0.4, 6 dhe 20 kV

4.1 Fazat e projektit të zbatimit

Nga N/St. Fushë-Krujë 110/20/6 Kv do të sistemohen të gjitha linjat përgjate trasesë të rrugës së re.

4.2 Kriteret e projektimit

Kriteret e projektimit që përdoren për të përcaktuar llojin e linjës, tipin e kabullit të përdorur janë prezantuar më poshtë.

Kabulli që do të vendoset për një fazë, do jetë alumini me izolacion XLPE me seksion $1 \times 240 \text{mm}^2$, $1 \times 185 \text{mm}^2$ pra me dell tek dhe për tensionin e ulët do vendoset kabull TU me izolacion XLPE me seksion $4 \times 50 \text{mm}^2$ deri në $4 \times 95 \text{mm}^2$ me mbrojtje tërthore dhe gjatësore kundra ujit. Seksioni kabullit është llogaritur për të mbajtur ngarkesën e konsumatorëve.

5. Dokumentacioni

Ky relacion është pjesë e projektit “*Spostimi i linjave TM/TU që ndodhen në aksin e ri rrugor Thumanë-Tapizë.*” projekt i cili shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Relacioni teknik
2. Projekti
3. Preventivat
4. Specifikimet teknike

Përgatiti: